

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 24 MARS 2022

Të nderuar kolegë,

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar banorë të zonës së “5 Majit” në Tiranë dhe të Laprakës,

Të nderuar banorë dhe votues së zonës sime të Paskuqanit,

Kjo interpelancë ka zënë fill nga babëzia qeveritare e ushtruar dhe e shkaktuar ndaj këtyre banorëve nga situata e rëndë e krijuar në këto zona, për shkak të aplikimit nga ana e qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës të disa projekteve korruptive, dhe çka është edhe më e rënda, e zbatimit të tyre me dhunë, me sjellje barbare nga ana e qeverisë, madje edhe me terror, në shkelje flagrante të ligjeve të këtij vendi, të Kushtetutës së këtij vendi, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në shkelje të Kartës Sociale Europiane.

Zonja Ministre,

Është bërë e udhës të shohim gjatë këtyre 9 vjetëve që pas çdo projekti qeveritar fshihet rëndom një akt i thellë korruptiv dhe kjo gjë po e rrënon shtetin, pasi qeveria juaj nuk ka ndjeshmëri në këtë aspekt dhe babëzinë e ka shndërruar në normë. Por shqetësohemi dhe është tmerrësisht e dhimbshme kur e shohim shtetin tonë të sillet me qytetarët e tij si një bandë e strukturuar e kriminit të organizuar sa herë që ka një projekt që quhet dhe u shitet shqiptarëve si “projekt zhvillimi”. Ato skena që kemi parë te “5 Maji” janë barbari të denja për filmat horror. Për një gjë të jeni të sigurt, se atë që u keni bërë dhe po u bëni këtyre shqiptarëve legjitimë në këto zona, nuk jua ka bërë kurrë as pushtuesi. A keni parë ndonjëherë skena të tilla si ajo që patë me nënë Lizën, një plakë fisnike, në shtëpinë dhe në pronën e vet, që kapet zvarrë nga policët sikur të ishte një barbare? A keni parë ndonjëherë që fëmijëve dhe bebeve në krevatin e vogël në dhomën e gjumit t’u hidhet gaz lotsjellës? A është parë gjëkund që fëmijët të lidhen dhe të mbahen për krahësh me dhunë nga policët dhe të shohin se si u thyhet krevati, si u prishet shtëpia dhe si u rrënohen dhe u shkelen lodrat e tyre? A keni parë ndonjëherë skena ku dhunohen dhe kapen zvarrë prindërit në sytë e fëmijëve? Jo, besoj se nuk keni parë askund, as pushtuesit nuk ua kanë bërë shqiptarëve këtë gjë. Po, ua kanë bërë dikur pushtuesit osmanë dhe serbë, por pushtues të tjerë jo.

Zonjë, a mos vallë këta qytetarë, që po ngrenë zërin në mbrojtje të tyre, janë kundër zhvillimit, sepse janë etiketuar si të tillë, apo ne që jemi sot për t’i mbrojtur ata jemi kundër zhvillimit? Pra, përveçse u vodhën, përveçse u dhunuan, përveçse u shkelën me këmbë, tani edhe po poshtërohen. Zonja Ministre, askush nuk është kundër projekteve zhvilluese qoftë në bashkinë tonë, qoftë edhe në Shqipërinë tonë, por kur këto projekte zbatohen në shpërfillje të ligjeve dhe kur me qytetarët nuk konsultohen, madje as nuk njoftohen, kur korrupsioni dhe babëzia ulëret para syve të tyre, kur u vidhet toka, kur u

shkatërrohet shtëpia dhe prona, siç ndodh tani, kur këto projekte zbatohen me dhunë dhe terror, është kambanë alarmi dhe duhet të reagojnë jo vetëm ata, jo vetëm ne, por duhet të reagojë çdo shqiptar. Në këto zona, pavarësisht se një pjesë e madhe e banesave janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme, duhet theksuar që këto banesa janë regjistruar prej vitesh në procedurat e legalizimit në zbatim të ligjit nr. 9482, të datës 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Zonja Ministre, a e dini se këto shkelje dhe këto shpronësime nuk kanë ndodhur dhe nuk ndodhin në asnjë vend demokratik? A e dini se banorët nuk kishin shkresë apo informacion zyrtar nga shteti për atë çfarë do t’ju ndodhte? A e dini se sot që po flasim në Paskuqan kanë shkuar pa asnjë njoftim forcat e IKMT-së dhe të Policisë së Shtetit për të nxjerrë bizneset dhe familjet nga shtëpitë? Asnjë dokument apo njoftim paraprak qoftë për të shpërngulur edhe pjesën e materialeve të tyre personale. Ku ndodhin situata dhe gjëra të tilla, zonja Ministre, përveçse këtu? A e dini se te “5 Maji” shpronësimi nuk është për interesa publike, zonja Ministre, por është për interesa private, sepse nuk ka zhvillim dhe nuk po ndërtohet ndonjë projekt i madh publik në atë vend? Atje po ndërtohen pallate ku nxirren fitime nga privati. A e dini se pse Erion Veliaj, nën pretekstin e zhvillimit, po zhvillon afëra korruptive dhe mafioze në atë zonë?

A mund të na thoni, zonjë, se çfarë është ajo shoqëria DT sh.a., e ngritur nga Bashkia e Tiranës, nga Erion Veliaj, përveçse korrupsion i pastër dhe i dënueshëm me ligj për t’iu shmangur tenderit, për të eliminuar konkurrencën dhe për të proceduar më pas me kontrata nënkontraktore? Të gjitha këto bëhen në kurriz të ligjit, në kurriz të qytetarëve dhe në kurriz të banorëve. Nuk mund t’i bëjë këto shteti dhe i bën banda. Është banda e pushtetit, zonjë, e cila ka 9 vjet që u ka hipur në shpinë shqiptarëve dhe vetëm i rrjep, i dhunon, i plaçkit dhe i poshtëron.